



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

---

**V E N D I M**

Nr. 4, datë 18.10.2013

**PËR**  
**MASAT EMERGJENTE TË NDËRHYRJES MBROJTËSE**  
**DHE REHABILITUESE NË ZONAT ME RËNDËSI KOMBËTARE**  
**MJEDISORE**

Në mbështetje të nenit 6, 8, nenit 32, të Ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së, nr. 676 datë 20.12.2002, “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqiptare”, VKM-së nr 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e atyre zonave ku do të ndërmerren masa të natyrës emergjente me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e zonave me rëndësi kombëtare mjedisore dhe monumenteve natyrore sipas listës përkatëse dhe hartës ilustruese të Ministrisë së Mjedisit.
2. Pezullimin e dhënies së të gjitha llojeve të lejes zhvillimore në këto zona, nga autoritetet e planifikimit, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.
3. Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, autoritetet e planifikimit lejohen të japin leje zhvillimore në këto zona, vetëm për këto raste përjashtimore:

1. Punime mirëmbajtjeje;
2. Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.
  
4. Ministria e Mjedisit të bëjë evidetimin dhe përditësimin e të dhënave për statusin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe monumenteve natyrore, si edhe të përcaktojë rregullat që kanë ndikim në planifikimin e territorit për secilën kategori të këtyre zonave të mbrojtura.
  
5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale dhe Inspektoriat Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, për marrjen e masave emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese në këto zona.
  
6. Ngarkohen autoritetet e planifikimit për ndjekjen dhe zbatimin e pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi.
  
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**




**ZËVENDËS KRYETARE E K.K.T**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

*Eglantina Gjermeni*



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË  
TERRITORIT**

*Adelina Greca*

